

## Akt Themelimi

I shoqërisë tregtare “AUTO – FABJO” sh.p.k

Sot më datë 03.04.2024, unë i nënshkruari:

1. Fabion Reçi

me vullnetin tim të lirë dhe të plotë në mbështetje të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare “ hartoj këtë Akt Themelimi të Shoqërisë “AUTO – FABJO“ sh.p.k, si më poshtë vijon:

### 1. FORMA LIGJORE

“AUTO – FABJO “ sh.p.k është një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar.

### 2. ORTAKU THEMELUES

Ortaku i vetëm themelues i shoqërisë tregtare është :

a. Fabion Reçi

### 3. OBJEKTI

Shoqëria do të krijohet me qëllim:

- Import – Export dhe shitja e automjeteve.

### 4. SELIA E SHOQËRISË

Selia e shoqërisë tregtare “AUTO - FABJO“ SHPK do të jetë në adresën: Tiranë, Vorë, Prezë Ahmetaq, Godina nr. 11, Kati 1, Zona kadastrale Nr. 1006, Nr pasurie 163/28

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj , të hapë zyra përfaqësie , degë , të krijojë filiale në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë , vetëm me vendim të asamblesë dhe ortakëve të saj .

Shoqëria ka vulen e saj me madhesi te zakonshme, me tekstin rreth saj .

### 5. KOHËZGJATJA

Shoqëria krijohet për të vepruar për gjithë kohën e përcaktuar për sa kohë do ketë treg në shitjen e produkteve të saj ushqimorë.

### 6. KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali themeltar i shoqërisë tregtare “AUTO – FABJO “ sh.p.k është 100.000 (njëqindmijë) lekë

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë tregtare mund të shtohet ose të pakësohet ( por jo nën vlerën e kapitalit themeltar fillestar ).

## 7. ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME ORTAKËVE DHE PËRFAQËSUESI LIGJOR

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të shoqërisë tregtare “AUTO - FABJO “ sh.p.k është edhe organi më i lartë i saj.

Përfaqësuesi ligjorë të shoqërisë do të jetë \_ Fabion Reçi.

## 8. DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

8.1 Shoqëria do të administrohet nga 1 (një) administrator i vetëm i emëruar dhe i pandryshueshëm në përputhje me këtë statut për të gjithë kohëzgjatjen e shoqërisë.

8.2 Administratori i Shoqërisë mund të shkarkohet nga pozicioni që ka në Shoqëri në çdo kohë nga Asambleja e Ortakëve me Shumicë të Zakonshme. Në asnjë rast ortakëve nuk i duhet të justifikojnë apo provojnë se cilat janë shkaqet për të cilat ata shkarkojnë administratorin. Në çdo rast janë ortakët ata të cilët vlerësojnë se ka shkaqe të arsyeshme për shkarkimin e administratorit

8.3 Administratori ka të drejtë të përfaqësojë Shoqërinë në mënyrë të plotë për administrimin e zakonshëm të saj si edhe të drejtën për të miratuar të gjitha vendimet që i gjykon të përshtatshme për arritur dhe përmbushur qëllimin e shoqërisë, me përjashtim të vendimeve që me ligj i takojnë Asamblesë së Ortakëve.

Administratori mund të autorizojë palë të treta për ta përfaqësuar atë në transaksione të veçanta me anë të një prokure të hartuar para noterit.

8.4 Personi i mëposhtëm do të caktohet si Administrator i Shoqërisë për një afat **5 vjeçar** për të gjithë periudhën e kohëzgjatjes së shoqërisë:

Z. Fabion Reçi, shtetas shqiptar, i biri i Muharrem, i datëlindjes 10.08.1993, lindur dhe banues në Laç, mbajtësi I kartës së identitetit me numër 037146033 dhe numër personal J30810086G, lëshuar nga Ministria e Brendshme datë 12.04.2021.

## 9. PRISHJA DHE LIKUJDIMI I SHOQËRISË

Prishja dhe likuidimi i shoqërisë tregtare mund të bëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo shkak ligjor, duke përfshirë dhe falimentimin, pavlefshmëria e themelimit të shoqërisë të parashikuar nga ligji, për çdo shkak tjetër të vendosur me vullnetin e ortakëve të shoqërisë.

## 10. TË NDRYSHME

Akti i themelimit të shoqërisë u përpilua në 2(dy) ekzemplarë, njëra për tu dorëzuar pranë organeve kompetente dhe tjetra do të mbetet në dosjen e dokumentacionit të krijimit të shoqërisë “AUTO – FABJO” sh.p.k

Akti i themelimit të shoqërisë nënshkruhet rregullisht nga ortaku themelues .

**ORTAKU THEMELUES**

**E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**“AUTO – FABJO “ Sh.p.k**

*Fabion Reçi*